

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të Nenit 12 paragrafit 3, nën-paragrafit 3.1 dhe Nenit 32 paragrafit 4 të Ligjit nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare nr.1, 17 janar 2022), Kuvendi i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës miraton:

RREGULLORE PËR EDUKIMIN E VAZHДУESHËM PROFESIONAL TË INXHINIERËVE TË LICENCUAR

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i përmbajtjes së programit, mënyrës së trajnimeve dhe sistemit të evidentimit të pikëve kredituese, si pjesë e edukimit të vazhdueshëm profesional që inxhinierët e licencuar janë të obliguar të ndjekin.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për Odën e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda) dhe organet e saj si dhe të gjithë inxhinierët e licencuar që ushtrojnë veprimtarinë profesionale në Republikën e Kosovës, përfshirë anëtarët e Odës të cilët kanë të drejtë të ndjekin edukimin e vazhdueshëm profesional.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji në fuqi).
2. Emrat në njërin gjini të përdorura në këtë Rregullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.

KAPITULLI II PROGRAMI, MËNYRA E TRAJNIMEVE DHE SISTEMI I EVIDENTIMIT TË PIKËVE KREDITUESE

Neni 4

Edukimi i vazhdueshëm profesional

1. Inxhinieri i licencuar nga Oda dhe që është anëtar i Odës është i obliguar që t'i nënshtrohet edukimit të vazhdueshëm profesional për avancimin e shkathhtësisë të profesionit që e ushtron dhe për mbajtjen e licencës.

2. Edukimi i vazhdueshëm profesional zhvillohet përmes trajnimeve, tryezave të rumbullakëta, punëtorive dhe aktiviteteve tjera të ngjashme

Neni 5

Programi i edukimit të vazhdueshëm profesional

1. Oda harton Programin e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (në tekstin e mëtejshëm: Programi) i cili miratohet nga Bordi Drejtues i Odës për një periudhë një (1) vjeçare që korrespondon me vitin kalendarik.

2. Programi ka për qëllim ofrimin e njohurive bashkëkohore të fushës së inxhinierisë për pjesëmarrësit, dhe ndahet në pjesën profesionale dhe atë teknike-rregullative.

3. Programi i miratuar përmban llojet e aktiviteteve të edukimit profesional që do të organizohen gjatë vitit, përfshirë:

3.1. përmbajtjen e tyre;

3.2. kohëzgjatjen;

3.3. trajnerët, gjegjësisht udhëheqësit e angazhuar në realizimin e aktivitetit;

3.4. vendin e mbajtjes dhe

3.5. numrin e kredive për secilin aktivitetet veç e veç që do të fitohen nga inxhinieri i licencuar për ndjekjen e aktivitetit.

4. Një aktivitet i Programit mund të ketë dy (2) ose tre (3) pikë kredituese, ndërsa Programi një (1) vjeçar i përbërë nga aktivitetet, gjithsej njëzet (20) pikë kredituese.

5. Së paku një e treta (1/3) e aktiviteteve të Programit janë të natyrës teknike-rregullative.

Neni 6

Ofruesit e edukimit të vazhdueshëm profesional

Aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional ofrohen nga Oda dhe nga çdo organizatë tjetër për ofrimin e trajnimeve me të cilën Oda lidh marrëveshje.

Neni 7

Organizimi i aktiviteteve të vazhdueshme profesionale nga Oda

1. Për aktivitetet e vazhdueshme profesionale të ofruara nga Oda, Administrata e Odës është përgjegjëse për:

1.1. Organizimin dhe mbarëvajtjen e tyre, përfshirë pjesën e logjistikës;

1.2. kontraktimin e trajnerëve, gjegjësisht udhëheqësve të angazhuar në realizimin e aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm profesional;

1.3. përgatitjen e raporteve të rregullta të aktiviteteve, përmes Drejtorit Ekzekutiv, për Bordin Drejtues dhe organet tjera të Odës;

1.4. propozimin e aktiviteteve për Programin e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional;

1.5. mbajtjen e regjistrave të edukimit të vazhdueshëm profesional përmes sistemit elektronik, duke përfshirë evidentimin e aktiviteteve të organizuara qoftë nga Oda apo ofruesit tjerë të edukimit, pjesëmarrësit, pikët kredituese dhe të dhënat tjera përkatëse, dhe

1.6. detyra dhe përgjegjësi tjera lidhur me fushën e edukimit të vazhdueshëm profesional.

2. Aktivitetet e organizuara nga Oda janë pa pagesë për inxhinierin e licencuar, përveç nëse kjo Rregullore parasheh ndryshe.

Neni 8

Kreditimi i pikëve nga inxhinieri i licencuar

1. Inxhinieri i licencuar është i obliguar të arrij së paku tetë (8) pikë kredituese gjatë Programit një (1) vjeçar.

2. Përfshirë nga paragrafi 1, në vitin e parë të licencimit, inxhinieri është i obliguar të arrij vlerën përkatëse të pikëve sipas periudhës së licencimit që korrespondon me atë vit kalendarik, sipas përcaktimit dy (2) pikë kredituese për periudhën tre (3) mujore të licencimit.

Neni 9

Ndjekja e trajnimeve profesionale jashtë vendit

1. Inxhinieri ka të drejtë të ndjek trajnime profesionale në fushën e inxhinierisë, nga organizatat apo institutet e akredituara jashtë vendit, me kushtin që këto trajnime të ofrojnë pikë kredituese sipas sistemit përkatës.

2. Për të fituar pikë kredituese në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional, nga trajnimi sipas paragrafit 1, inxhinieri që ndjek trajnimin paraqet kërkesë për njohjen e trajnimit tek Administrata e Odës, së bashku me të dhënat e trajnimit dhe dëshmitë përkatëse.
3. Pas verifikimit të trajnimit të mbajtur dhe lidhshmërisë me fushën profesionale të inxhinierit, Drejtori Ekzekutiv i Odës i propozon Bordit Drejtues njohjen e pikëve kredituese për inxhinierin e licencuar gjatë vitit kalendarik sipas Programit të ndjekur. Trajnimi i ndjekur jashtë vendit mund të llogaritet me më së shumti tre (3) pikë kredituese.
4. Kundër vendimit të Bordit Drejtues për mos-njohjen e pikëve kredituese sipas këtij Neni, inxhinieri i licencuar ka të drejtë të paraqes ankesë në Komisionin e Ankesave.

Neni 10

Pjesëmarrja në aktivitetin e edukimit të vazhdueshëm profesional

1. Aktiviteti i edukimit të vazhdueshëm profesional mbahet me prezencë fizike të pjesëmarrësve.
2. Aktiviteti mund të zhvillohet edhe përmes mjeteve të teknologjisë informative të komunikimit apo mësimin në distancë, por duke siguruar kualitetin e njëjtë të edukimit profesional. Numri i këtyre aktiviteteve nuk mund të jetë më i lartë se një e treta (1/3) e të gjitha aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Programit një (1) vjeçar.
3. Ofruesi i aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm profesional vë në dispozicion paraprakisht për pjesëmarrësit, materialet përkatëse dhe të dhënat tjera lidhur me aktivitetin.
4. Ofruesi i aktivitetit lëshon certifikatën përkatëse për pjesëmarrësin që vërteton përfundimin e suksesshëm të aktivitetit.
5. Certifikata nga paragrafi 4 përmban:
 - 5.1. emrin, mbiemrin dhe numrin e licencës të pjesëmarrësit;
 - 5.2. emërtimin, llojin dhe datën e aktivitetit;
 - 5.3. numrin e pikëve kredituese, dhe
 - 5.4. nënshkrimin e personit përgjegjës dhe vulën e ofruesit të aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm profesional nëse zbatohet.
6. Aktiviteti i edukimit të vazhdueshëm profesional mund të mbahet më shumë se një (1) herë gjatë zbatimit të Programit një (1) vjeçar, apo në kuadër të Programeve pasuese, për të mundësuar qasje për të gjithë pjesëmarrësit e interesuar.

Neni 11
Mos përmbushja e pikëve kredituese

1. Inxhinieri i cili nuk përmbush pikët kredituese sipas Nenit 8 në kuadër të Programit një (1) vjeçar, i pezullohet licenca.
2. Gjatë kohës së pezullimit të licencës për shkak të mos-përmbushjes së pikëve kredituese, Inxhinieri është i obliguar që të fitoj pikët kredituese të mbetura nga viti kalendarik paraprak gjatë periudhës së gjashtë (6) mujorit të parë të Programit pasues një (1) vjeçar.
3. Bordi Drejtues i Odës mund të vendos që Inxhinieri i pezulluar sipas paragrafit 1, të paguaj shumë të caktuar për ndjekjen e aktivitetit të organizuar nga Oda në përputhje me paragrafin 2.

Neni 12
Pamundësia për të ndjekur edukimin e vazhdueshëm profesional

Inxhinieri që për shkak të mos zhvillimit të aktiviteteve profesionale, të drejtave prindërore sipas ligjit të veçantë, apo sëmundjes së vazhdueshme të diagnozës së njëjtë më të gjatë se njëqindetëdhjetë (180) ditë, nuk ka pasur mundësi të ndjek aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional gjatë Programit një (1) vjeçar, lirohet përkohësisht nga detyrimet e kësaj Rregulloreje, pas propozimit të Drejtorit Ekzekutiv të Odës dhe me vendim të Bordit Drejtues kundrejt dëshmimeve të ofruara.

KAPITULLI III
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13
Fillimi i zbatimit të edukimit të vazhdueshëm profesional

Edukimi i vazhdueshëm profesional fillon të zbatohet në vitin e parë pasues kalendarik pas mbajtjes së Kuvendit themelues të Odës dhe zgjedhjes së organeve të saj.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Odës dhe publikohet në faqen elektronike të Odës.

Arsim Rapuca



Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës